VENDIM
Nr.912, datë 23.12.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.117, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr.117, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, zëri "Shpronësime", për vitet 2009-2010.".

2. Fondi prej 83 532 200 (tetëdhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind) lekësh, që i përket llogarisë së veçantë të Ministrisë së Financave "Fondi i shpronësimeve", të përdoret për përballimin e shpronësimit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për segmente të tjera rrugore nacionale, ku është parashikuar përballimi i shpronësimit po nga ky fond, për të cilat procesi i likuidimit për efekt shpronësimi nuk është përfunduar deri në këto momente.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha